



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

**PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E
PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË
MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Projektvendimi, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, mundëson përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike që punojnë jashtë vendbanimit dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit. Gjithashtu, ky projektvendim synon krijimin e kushteve më të mira të punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), të institucioneve arsimore parauniversitare publike që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 km deri në 50 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, si dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit për kategoritë përfitues të cituara më lart.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave. Projektvendimi është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për t’u miratuar në vitin 2023, në zbatim të vendimit nr. 862, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave “Për

miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”.

Bazuar në nenin 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", që përcaktojnë rregulla për veprimtaritë publike të institucioneve në periudhën 4 (katër) muaj përpara datës së zgjedhjeve dhe referuar shkresës nr. 139 prot., datë 11.01.2023 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me lëndë: "Kujtesë mbi veprimtarinë e institucioneve publike 4 (katër muaj) përpara datës së zgjedhjeve", ky projektvendim nuk përcakton zhvillimin e veprimtarive të ndaluar për t'u promovuar, me të cilat konsiderohen ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Ky projektvendim, që propozohet për miratim, nuk përfshihet në kategorinë e akteve të ndaluara në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve".

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË DHE EFEKTET E PRITSHME

Në përgatitjen e këtij projektvendimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka marrë parasysh parashikimet e ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe janë mbajtur parasysh edhe kërkesat e ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportin rrugor", i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023".

Ky projektakt është në përputhje me Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, e miratuar me vendimin nr. 348, datë 11.5.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020". Objektivi strategjik III, në këtë dokument, është "Investimi tek Kapitali njerëzor dhe rritja e Kohezionit Social", ku investimet në rritjen e cilësisë së arsimit

përbëjnë një nga shtyllat kryesore. Ndër sfidat kryesore në arsimin e lartë përfshihet nevoja për sigurim të arsimit që korrespondon me nevojat e fushave specifike dhe zhvillimet e rajoneve specifike përmes: “Drejtimin të profileve dhe diferencimi i institucioneve të arsimit të lartë për t’u përgjigjur më mirë kërkesës së tregut të punës, nevojave për zhvillim kombëtar dhe rajonal dhe procesit të integritimit në BE”. Ky projektakt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” (SKA 2021-2026), qëllimi i Politikës C, sipas SKA 2021-2026, për arsim të lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Projektvendimi synon ofrimin e transportit publik falas për kategoritë si më poshtë:

- a) punonjësit arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike (në vijim IAP publike), ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km.
 - b) nxënësit që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht);
 - c) nxënësit që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në IAP-të publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);
 - ç) nxënësit e arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.
 - d) nxënësit që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruksion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm.
- Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë IAP-të publike (shkollë/kopsht).

Gjithashtu nëpërmjet projektvendimit synohet të përcaktohet qartë mënyra e përlogaritjes së masës së shpenzimeve për nxënësit/fëmijët dhe punonjësit arsimorë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, neneve 5, 6, 19, 28 dhe pikës 5, të nenit 37, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut II, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 84/2022, datë “Për buxhetin e vitit 2023”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet më çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis të BE-së*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, përbëhet nga 10 (dhjetë) pika, me përmbajtje si më poshtë:

Në **pikën 1** të projektvendimit përcaktohet se shpenzimet për transportin përballohen nga fondet publike për kategoritë si më poshtë:

- a) punonjësit arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike (në vijim IAP publike), ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km.
- b) nxënësit që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht);
- c) nxënësit që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në

- IAP-të publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);
- ç) nxënësit e arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik.
- d) nxënësit që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruksion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm.

Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë IAP-të publike (shkollë/kopsht).

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore miratojnë rrjetin e linjave të transportit rrethqytetas, mbështetur në numrin e fëmijëve/nxënësve dhe të punonjësve arsimorë të IAP-ve publike, që planifikohen të përfitojnë nga ky shërbim, sipas kriterëve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, bazuar në informacionin që marrin nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), brenda muajit tetor për vitin e ardhshëm buxhetor. Listat e përfituesve konfirmohen nga ZVAP-të pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për distancën nga vendbanimi i përhershëm dhe dërgohen në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP), për të realizuar procedurën e prokurimit publik, brenda muajit nëntor, për vitin e ardhshëm buxhetor.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se DRAP-et prokurojnë me fonde publike shërbimin e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, sipas rrjetit të linjave të transportit rrethqytetas, të miratuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshilli i qarkut, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Përlllogaritja e fondeve që prokurohen kryhet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të mësuesve që përfitojnë shërbim transporti vetëm për ata punonjës arsimorë që udhëtojnë brenda linjave të transportit rrethqytetas, numrit të nxënësve që përfitojnë shërbimin e transportit dhe çmimit të indeksuar me normën e inflacionit të biletës për linjat rrethqytetëse të transportit, të miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, duke shtuar, vetëm për nxënësit, edhe 50 (pesëdhjetë) përqind mbi çmimin e indeksuar të vlerës së biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit rrethqytetas, të parashikuar në pikën 3, të këtij

vendimi, nuk realizohet me sukses nga DRAP-i, me autorizimin e kësaj të fundit, ZVAP-ja siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimor të IAP-së publike përfitues, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, të kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve arsimorë të IAP-së publike përfitues ose nëpërmjet shërbimit postar vetëm për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, deri në përfundim të vitit buxhetor.

Masa e shpenzimeve nga ZVAP-të llogaritet vetëm mbi bazën e numrit të ditëve mësimore të realizuara, numrit të punonjësve arsimorë që janë paraqitur në punë, numrit të nxënësve që kanë ndjekur mësimin dhe çmimit të biletës, të miratuar me VKM-në nr. 146, datë 26.2.1998, të ndryshuar, i cili indeksohet me normën vjetore të inflacionit, duke shtuar, vetëm për nxënësit, edhe 50 (pesëdhjetë) përqind mbi çmimin e indeksuar të vlerës së biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se punonjësve arsimorë të cilët janë të punësuar në IAP publike, jashtë bashkisë së vendbanimit të tyre, në distancat sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, u paguhet çmimi i indeksuar me normën e inflacionit të biletës së linjave ndërqytetëse të transportit, në masën e përcaktuar në VKM-në 146, datë 26.2.1998, të ndryshuar, në përputhje me numrin e ditëve që janë paraqitur në punë, të konfirmuara nga drejtori i institucionit arsimor. Pagesa për këtë kategori punonjësish kryhet në llogaritë e tyre bankare dhe kjo kategori punonjësish nuk përfshihet në përlllogaritjen e fondit, sipas pikës 3 të këtij vendimi.

Në pikën 6 të projektvendimit përcaktohet se punonjësit arsimorë, që përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit të siguar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë kompensim mujor të diferencuar, sipas pikës 4.a), të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar” i ndryshuar, për distancat, si më poshtë vijon:

- a) në masën 1 000 (njëmijë) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm i tyre deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 5 km deri në 10 km;
- b) në masën 1 500 (njëmijë e pesëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm/ deri në institucionin arsimor publik është në

distancën mbi 10 km deri në 20 km;

- c) në masën 2 700 (dymijë e shtatëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm/ deri në institucionin arsimor publik është në distancën mbi 20 km deri në 50 km.

ZVAP-et dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe koordinojnë të dhënat për numrin e përfituesve e largësitë nga vendbanimi dhe raportojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, çdo 3 (tre) muaj.

Në pikën 7 të projektvendimit përcaktohet se punonjësit arsimorë të cilët janë punësuar në IAP publike, në distancë nga vendbanimi mbi 50 km dhe nuk përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit sipas këtij vendimi, përfitojnë shpërblim mujor sipas pikës 4.b) të VKM-së nr. 175, datë 8.3.2017, të ndryshuar.

Në pikën 8 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin, e cila rishpërndan fondet përkatëse të ZVAP-et, si dhe nga buxheti i njërive të vetëqeverisjes vendore, në rastet kur, me vendim të organeve kolegjiale, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të financojnë shpenzime transporti për nxënësit dhe punonjësit e arsimit parauniversitar publik edhe për distanca të tjera, jashtë përcaktimeve të këtij vendimi.

Në pikën 9 të projektvendimit përcaktohet shfuqizimi i vendimit nr. 682, datë 9.7.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar.

Në pikën 10 të projektvendimit përcaktohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e vendimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoritë Rajonale të arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për hartimin e këtij projektvendimi ka kontribuar grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 46, datë 25.01.2023 “Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projektakteve në zbatim të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2023”.

Projektvendimi është dërguar për konsultim me shkresën nr. 8176 prot., datë 15.12.2022 të MAS, drejtuar Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, të cilët kanë përcjellë disa mendime rreth projektvendimit. Pas diskutimeve edhe nëpërmjet takimeve të zhvilluar me përfaqësues të këtyre organizmave, është hartuar projektvendimi i cili ju paraqitet për mendim ministrive të linjës.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë në masën 1,370,000,000 lekë (një miliard e treqind e shtatëdhjetë milion) lekë, fonde që përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin për periudhën afatmesme 2023-2025. Nga ky projektvendim parashikohet të përfitojnë mbulimin e shpenzimeve të transportit rreth 38,168 fëmijë dhe nxënës për 175-180 ditë mësimorë në vit, si dhe 14,361 punonjës mësimorë për 195-200 ditë pune-mësimorë në vit ku përfshihen punonjësit mësimorë të arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km.

Fondet për mbulimin e efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi janë parashikuar në buxhetin afatmesëm 2023-2025, në programin buxhetor të arsimit bazë 09120, kapitulli 01, artikulli 602, kodi i produktit 91103AD, si dhe në programin e arsimit të mesëm të lartë 09230, kapitulli 01, artikulli 602, kodi i produktit 91104 AB.

PROPOZUESI

MINISTËR

EVIS KUSHI